

URDHËR
Nr.217, datë 1.4.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.164, DATË 12.03.2020 “PËR
MBYLLJEN E BAREVE, RESTORANTEVE DHE LOKALEVE, FAST-FOOD DHE
KUFIZIMIN E SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA STRUKTURAT
AKOMODUESE QË OFROJNË SHËRBIM PËR KLIENTËT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma “a”, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikat 1, 3 dhe 4, të urdhrit nr.164, datë 12.3.2020 “Për mbylljen e bareve, restoranteve dhe lokaleve, fast-food dhe kufizimin e shërbimeve që ofrohen nga strukturat akomoduese që ofrojnë shërbim për klientët”, togfjalëshi “deri në datën 3.4.2020”, zëvendësohet me togfjalëshin “deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**